



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:227217

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06001827

PA1.nr.77/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Mehmet Ndrecaj dhe Abdullah Ahmeti anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Ilmije Rexhepi Beqiri, në çështjen penale kundër të akuzuarve A.R.H dhe A.A.H që të dy nga fsh. ... Komuna e Klinës për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprë penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 401 par. 5 lidhur me par. 1 dhe nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Pejë, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.243/2022, datë 13.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë **23.07.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë, ndërsa aktgjykimi Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.243/2022, datë 13.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë -Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.243/2022, datë 13.12.2023, me aktgjykimin e ankimuar të akuzuarit A.R.H dhe A.A.H, i ka shpallur fajtor për veprën penale Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 401 par. 5 lidhur me par. 1 dhe nenin 31 të KPRK-së dhe i ka shqiptuar të akuzuarit të parë A.H dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, me pëlqimin e të pandehurit Konform nenit 44 të KPRK-së, dënimi i shqiptuar me burg prej 6 (gjashtë) muajve, iu zëvendësua me dënim me

gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) €, të cilën shumë obligohet i pandehuri që ta paguaj brenda afati kohor në kohë zgjatje prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën e shqiptuar sipas afatit të dhënë, e njëjta gjobë do të zëvendësohet në dënim me burg, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, ku një ditë burgim do ti llogaritet në 20 euro të gjobës. 2. A.H e dënon me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, me pëlqimin e të pandehurit Konform nenit 44 të KPRK-së, dënimi i shqiptuar me burg prej 6 (gjashtë) muajve, iu zëvendësua me dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) €, të cilën shumë obligohet i pandehuri që ta paguaj brenda afati kohor në kohë zgjatje prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën e shqiptuar sipas afatit të dhënë, e njëjta gjobë do të zëvendësohet në dënim me burg, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, ku një ditë burgim do ti llogaritet në 20 euro të gjobës. Obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor secili të paguaj shumën në vlerë prej njëzet (20) €, si dhe komfor nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L 036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguajë shumën prej 30 € tridhjetë, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Udhëzohen: Të dëmtuarit B.G, zyrtar pran Stacionit Policor në Klinë, me nr. ID. dhe M.B, zyrtar pran Stacionit Policor në Klinë, me nr. ID. ... që kërkesën pasurore juridike ta realizoi në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur :

Prokuroria Themelore në Pejë, për shkak të shkeljes së Ligjit Penal dhe vendimit mbi dënimin ,duke i propozuar kolegjit penal të Gjykatës së Apelit që ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë Gjykatës Themelore në Pejë, ashtu që ndaj të akuzuarve A.H dhe A.H që të dy nga fshati ...Komuna Klinës, t'i shqiptoj dënim më të rëndë, për të cilën janë shpallur fajtor.

Prokuroria e Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.87/2024, të datës 19.01.2024, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarve t'i shqiptoj dënim më të rëndë .

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të KPPRK-së, konstatoj se:

- ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit, duke u bazuar në nenin 394 par. 1 të KPPRK-së, sipas detyrës zyrtare, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe në këtë drejtim, dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar është përpiluar në harmoni të plotë me dispozitat ligjore nga neni 369 i KPPRK-së, dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, në dispozitivin e këtij aktgjykimi janë përkthyer qartë të gjitha veprimet inkriminuese të të akuzuarit, në të cilat veprime manifestohen të gjitha elementet qenësore të kësaj vepre penale, për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor i akuzuari. Po ashtu dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar nuk është në kundërshtim me vetveten

e as me arsyetimin e të njëjtit, në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka paraqitur në mënyrë mjaftë të plotë dhe të qartë të gjitha arsyet përkitazi me faktet vendimtare me rastin e vendosjes në këtë çështje penale.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase as me ankesë nuk ka mund të kontestohet, për faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë, dhe gjyqtari i vetëm gjykues e ka aprovuar një pohim të tillë, dhe bazuar në nenin 383 par.2 të KPPRK-së, aktgjykimin e ankimuar e vlerësoj vetëm në bazë të pretendimeve në ankesë të parashtruara nga ana e Prokurorisë Themelore në Pejë.

Aktgjykimi i ankimuar është goditur për shkak të shkeljes të Ligjit Penal, kolegji penal i Gjykatës së Apelit, duke u bazuar në nenin 394 par. 1 të KPPRK-së, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe sipas detyrës zyrtare për shkelje të ligjit penal në favor të të akuzuarit, dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë as me shkelje të Ligjit Penal në favor të të akuzuarit, në radhë të parë për faktin se nga pranimi i fajësisë nga i akuzuari dhe aprovimi i këtyre deklaratave nga Gjykata e shkallës së parë, është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, dhe me këtë rezulton se është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit janë manifestuar elementet qenësore të kësaj veprë penale për të cilën janë shpallur fajtor dhe gjykuar të akuzuarit, si dhe për faktin se kjo veprë për të cilën janë gjykuar të akuzuarit është veprë penale, nuk ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarit, dhe ndjekjen penale për këto vepra penale, dhe as zbatim të gabuar të Kodit Penal. Sa i përket pretendimit se nuk janë zbatuar dispozitat për zbutjen e dënimit nën minimumin e dënimit ndërsa gjykata ka shqiptuar dënim nën minimumin e dënimit nuk qëndrojnë pasi që gjykata e shkallës së parë ka marrë për bazë të gjitha rrethanat për zbutjen e dënimit sipas nenit 71 të KPRK-së e për shkak të gabimit teknik nuk ka cekur dispozitën e nenit 72 të KPRK-së.

Sipas vlerësimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e Prokurorisë Themelore, janë të pabazuara sa i përket vendimit për dënim, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarve, i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPK-së. Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, për të pandehurin A.H mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale sikurse më lart, ka marrë parasysh se i akuzuari ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, e që kjo është rrethanë e cila duke i ndërlidh me rrethanat tjera, si fakt se i njëjti është penduar për veprën e kryer penale, i njëjti për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin si rrethanë posaçërisht lehtësuese mori se i pandehuri, nga ajo ditë e gjerë me tani nuk kanë pas problem, po ashtu si rrethanë posaçërisht lehtësuese konform nenit 71 të KPRK-së, mori moshën relativisht e shtyrë i cili i ka të 8 vjet. Ndërsa, gjykata si rrethanë rënduese gjeti dashjen e kryerjes së veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Dhe për të akuzuarin A.H mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale sikurse më lart, është fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, e që kjo është rrethanë e cila duke i ndërlidh me rrethanat tjera, si fakt se i njëjti është penduar për veprën e kryer penale, i njëjti për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin si rrethanë posaçërisht lehtësuese mori se i pandehuri, nga ajo ditë e gjerë me tani nuk kanë pas problem, poashtu si rrethanë

posaçërisht lehtësuese konform nenit 71 të KPRK-së, i cili është i moshës relativisht të re. Ndërsa, gjykata si rrethanë rënduese gjeti dashjen e kryerjes së veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjukata e Apelit këtë konstatim të Gjykatës së shkallës së parë e vlerëson si të drejtë dhe në proporcion me dënimin e shqiptuar nga e njëjta. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë e cila do ta arsyetonte shqiptimin e një dënimi më të butë, ndaj të akuzuarve. Dhe bazuar në këto rrethana i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, me bindjen se dënimi është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve, e me të cilin dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, në kuptim të nenit 38 të KPRK-së.

Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë, të cilat rrethana i aprovon edhe kolegji penal i kësaj gjykate, edhe bazuar në rrethanat relevante ekzistuese në rastin konkret, dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, është dënim i drejtë, i ligjshëm, në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale të kryer dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve, dhe se kolegji penal i kësaj Gjykate, vlerëson se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, e i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, në kuptim të nenit 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.77/2024, me datë 23.07.2024

Bahkëpunëtorja profesionale

Ilmije Rexhepi Beqiri

Kryetari i kolegjit

Ferit Osmani

Antarët e kolegjit:

Mehmet Ndrecaj

Abdullah Ahmeti